


AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AMA-ERIS 2018 ” shpk



Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Ligji Nr. 131/2015 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT”

KREU I

Neni 1

Emertimi

Shoqeria do te emertohet “AMA-ERIS 2018 ” shpk dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “AMA-ERIS 2018 ” shpk është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortakut i vetem: **ARBEN DINO MEMAJ**, lindur me 11.08.1974, ne Cakran, Fier dhe banues ne Cakran i Ri, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit me Leternjoftim me nr personal H40811011N, me nr. Kontakti : +355 69 22 78 214

I cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojn personalisht humbjet e shoqërisë deri ne 100 % pjese te kontributit te derdhur . Kontributi i ortakut te vetem përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Shoqeria e ka seline ne Njesia Administrative Cakran, fshati Cakran, rruga Cakran- Gorishove, objekti nr.12

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te te ortakut te vetem.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Transport udhëtarësh brenda dhe jashte vendit. Ndjekjen e grafikut dhe kordinim i linjave nderqytetore e qytetese, ne bashkpunim me pronat e autobuzave dhe shoqatat perkatese. Shitja e biletave te udhetimit per autobus dhe taksi dhe administrim te dokumentacionit te udhetimit te tyre. Transport mallrash dhe udhetaresh, agjensi turistike dhe transport turistik brenda dhe jashte vendit..

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e

regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznedit .

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mije) LEKE, i ndare ne 1 pjese ne vlere 100,000 (njeqind mije) Leke . Ky kapital do te ngurtesohet pasi shoqeria te jete regjistruar ne QKB Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortaku i vetem i shoqerise :

Z ARBEN DINO MEMAJ , lindur me 11.08.1974, ne Cakran, Fier dhe banues ne Cakran i Ri, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit me Leternjoftim me nr personal H40811011N qe perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Kapitali do te paguhet ne banke menjehere pas regjistrimit te Shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit .

Ortaku pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve ne masen te 100 % te kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit . Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja vendos për çështje si;

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetem regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejttojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë "AMA-ERIS 2018" shpk është z. **ARBEN DINO MEMAJ**, lindur me 11.08.1974, në Cakran, Fier dhe banues në Cakran i Ri, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje noterit me Leternjoftim me nr personal H40811011N, emëruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejta ripërteritje, duke filluar prej 27 Shtator 2018 deri në 27 Shtator 2023.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetem të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha

shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje nënë të ligjit < Per Qendren Kombetare të Biznesit >;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast ortakut të vetem merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14


Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplare në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mesipër pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "AMA-ERIS 2018 " shpik nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKU I VETEM

ARBEN MEMAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE VLORE

Noter: LUAN MUÇAJ

Adresa: Lagja "29 Nëntori", Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier
e-mail: luan_mucaj@yahoo.com
Cel: 09 25 67 901



Nr. 3181 Rep.

VËRTETIM NËNSHKRIMI PER AKTIN E THEMELIMIT

Sot ne Fier, ne date 27.09.2018 (dymije e tetembedhjete) para meje noterit publik Luan Muçaj, me zyre prane Gjykares se Rrethit Gjyqesor Fier, u paraqit personalisht shtetasi i meposhtem :

ARBEN DINO MEMAJ , lindur me 11.08.1974, ne Cakran, Fier dhe banues ne Cakran i Ri, Njesia Administrative Cakran, Bashkia Fier , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej meje noterit me Leternjoftim me nr personal H40811011N

Ne cilesine e ortakut te vetem shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ AMA-ERIS 2018 ” sh.p.k, i cili me vullnet te lire dhe deshire te plote nenshkroi kete “ AKT THEMELIMI” pasi ka rene dakort qe ta njohet si aktin e tij te themelimit.

Unë noterit me pergjegjesi ligjore e nenshkruaj ate ne baze te ligjit “ Per Noterine” .

**NOTER
LUAN N. MUÇAJ**